

Njoftim për përqendrimin me të cilin MVM Energetika SHPK, Budapest, Hungari do të fitojë kontroll mbi kompaninë "Energotehnika - Južna Bačka d.o.o Novi Sad", Republika e Serbisë dhe mbi kompaninë "Elektromontaža d.o.o Kraljevo", Republika e Serbisë

(lënda nr. 08-120/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 04.08.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrimin me të cilin MVM Energetika SHPK, me seli në Rr. Sentendrei nr. 207-209, H-1031 Budapest, Hungari, do të fitojë kontroll të vetëm mbi kompaninë "Energotehnika - Južna Bačka d.o.o Novi Sad", në adresën Put Novosadskog Partizanskog Odreda 1, 21000 Novi Sad, Republika e Serbisë, dhe mbi kompaninë "Elektromontaža d.o.o Kraljevo", në adresën Aerodromska 7, 36000 Kraljevo, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

MVM Energetika SHPK është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, pronari i vetëm i vërtetë i së cilës është shteti i Hungarisë. MVM Energetika SHPK është anëtar dhe, në të njëjtën kohë, subjekt kontrollues i grupit MVM Energetika SHPK (MVM Energetika SHPK dhe filialet e saj dhe subjektet e tjera të lidhura në tekstin vijues do të quhen bashkërisht "Grupi MVM").

Grupi MVM është një grup energjetik i integruar vertikalisht, tërësisht në pronësi shtetërore, veprimtaria e të cilit përfshin të gjithë sektorin energjetik hungarez. Me termocentralet e tij, rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, rrjetin e gazit natyror dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, si dhe tregtimin e gazit natyror (nga shitja me shumicë deri te shërbimet universale) dhe tregtimin e energjisë elektrike (nga shitja me shumicë deri te shitja direkte te konsumatorët), si një holding strategjik konkurrues, MVM është pjesëmarrës në tregun hungarez të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Grupi MVM është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes filialit të tij, MVM PARTNER SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në adresën 8-ma udarna brigada 43/3, 1000, Shkup, Maqedonia e Veriut, me NUAS: 6947832 ("MVM Shkup"). MVM Shkup kryesisht merret me tregtimin e energjisë elektrike në tregun zyrtar të energjisë elektrike.

Energotehnika - Južna Bačka d.o.o, dhe Elektromontaža d.o.o Kraljevo, ofrojnë shërbime për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve energjetike të të gjitha niveleve të tensionit, si dhe shërbime për prodhimin e energjisë dhe pajisjeve për klientët vendorë dhe ndërkombëtarë. Si Energotehnika - Južna Bačka d.o.o Novi Sad, ashtu edhe Elektromontaža d.o.o Kraljevo, gjenerojnë pjesën më të madhe të të ardhurave të tyre në tregun serb.

Energotehnika - Južna Bačka d.o.o Novi Sad, dhe Elektromontaža d.o.o Kraljevo, janë të pranishme në Maqedoninë e Veriut përmes filialit të tij EJB – ENERGOTEHNIKA -JUŽNA BAČKA– Dega Shkup, me seli në Rr. Pirinska nr. 25/1-2, 1000, Shkup, Maqedonia e Veriut, me numër regjistrimi/NUAS: 7106998 ("EJB Shkup"). EJB Shkup kryesisht merret me ndërtimin e linjave elektrike dhe linjave të telekomunikacionit.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimi, tregu relevant është tregu i ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës telekomunikuese dhe elektrike në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

05.08.2025

Shkup